



**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**  
**Nr. 02-060/01-0005630-7/26, dt. 10.02.2026**  
**Mitrovicë**

02-060/01-0005630-7/26  
10.02.2026

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, dhe nenit 51, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); neneve 13 paragrafi 1, nenparagrafi 1.4 dhe 61, paragrafi 2, të Statutit të Komunës; nenit 13, paragrafët: 1 dhe 3, si dhe nenit 14, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë dhe komiteteve tjera; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 10.02.2026, sjell këtë:

**VENDIM**

**Për formimin e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport**

1. Miratohet Vendimi për formimin e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.
2. Komiteti i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është në këtë përbërje:
  - 2.1 Gëzim Stavileci,
  - 2.2 Rinesa Preteni.
  - 2.3 Nazmije Sejdiu,
  - 2.4 Fjolla Habibaj, dhe
  - 2.5 Qefsere Barku
3. Kompetencat dhe aktivitetet e komitetit janë të përcaktuara me Rregulloren Komunale Nr. 01/2009 Për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, si në vijim:
  - 3.1 Të këshillojë dhe konsultohet me Drejtorinë e Arsimit dhe Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
  - 3.2 Të përgatisë rregullore, udhëzime dhe vendime për t'i dorëzuar Kuvendit të Komunës në miratim;
  - 3.3 Të dëgjojë apelet nga nxënësit në lidhje me kualitetin e mësimit dhe masave disiplinore;
  - 3.4 Të propozojë dhe mbështesë raportin shkollë-shoqëri në mes të shkollave dhe shoqërisë përreth, me institucionet publike dhe private, të cilat merren me arsimimin e personave;
  - 3.5 Të parashikojë dhe vlerësojë nevojat arsimore të komunës në të ardhmen;
  - 3.6 Të përcaktojë prioritetet globale për qytetin në sferat e Kulturës, Sportit dhe Rinisë;
  - 3.7 Të hartojë një program të investimeve kapitale në mënyrë që t'u ofrojë institucioneve kushtet e nevojshme;
  - 3.8 Të ofrojë një pasqyrë buxhetore dhe të bëjë rekomandimet e nevojshme;
  - 3.9 T'i kushtojë vëmendje të veçantë nevojave të lagjeve periferike dhe rajoneve rurale;
  - 3.10 Të mbështesë kremtimin e festave të njohura kombëtare dhe ndërkombëtare;
  - 3.11 Të paraqesë dhe rekomandojë për diskutim buxhetor ngjarjet e rregullta dhe të rëndësishme, festivalat e kampionatet; dhe
  - 3.12 T'i kushtojë kujdes të veçantë ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe historike të qytetit.
4. Zgjedhja e kryesuesit të komitetit bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të komitetit. Në rast të mungësës së kryesuesit, mbledhjen e kryeson anëtari më i vjetër i komitetit.
5. Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport i dorëzon Kuvendit të Komunës raportin vjetor të punës së tyre për shqyrtim dhe miratim.
6. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport është i lidhur me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
7. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI

Dorëzohet: 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit  
1 x 1 MAPL-së  
1 x 1 Arkivit  
Kopje: Kryetarit të Komunës  
Anëtarëve të komitetit